

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shqetësimi i Kanadasë: Rendi global po përjeton “çarje”
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/shqetesimi-i-kanadase-rendi-global-po-perjeton-carje-i588675
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 08:43:39 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 09:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	dbbe6247012fd110dc71a187a83a3588e88bb362aea4bfe601812a20148fd12e
TEKSTI	5284d51e71420b8f9f4c612b57ee275bb5e9e2bd53bfd766ed164787735ecb38
PAMJA	5bcf5aa8bf6338e7272da87a70b0e75ad8b9d1c0ef419a19ef19979cfc570ee1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	79b45b3a5cbb3098164ebde883c03a06a04d3c36e387d44f1f9a221e96203285
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	b15fa4fb9899cfd04d55deb4808016b106f413d91b2f45c6fda6e9991406fd0e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/79b45b3a5cbb3098164ebde883c03a06a04d3c36e387d44f1f9a221e96203285>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)
- [Hosteni](#)

English

Built and Monetized by

English

le Operacioni "Dosja 23" ne Zubin Potok, arrestohen nente te dyshuar per krime lufte urgoni me 90 kilograme kanabis ndalohej ne Kakavije, droga do te transportohej ne fundit

Shqetësimi i Kanadasë: Rendi global po përjeton “çarje”

TemA

27 Shtator 2026, 11:50 Bota TEMA



Rendi ndërkombëtar po përjeton “çarje, jo tranzicion”, tha të shtunën ministrja e Jashtme kanadeze Anita Anand, duke theksuar se fuqitë e mëdha po tërhiqen nga bashkëpunimi ekonomik dhe po sfidojnë gjithnjë e më shumë sovranitetin kombëtar.

“Rryma ka ndryshuar në rendin global”, tha Anand në sesionin e 81-të të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, duke paralajmëruar se integrimi ekonomik po çmontohet dhe se sovraniteti i shteteve, një nga shtyllat e Kartës së OKB-së, shpesh shpërfilllet.

Anand tha se Kanada do të përgjigjet kësaj situatë duke ndjekur një “autonomi më të madhe strategjike”, duke ulur varësinë nga një partner i vetëm dhe duke zgjeruar marrëdhëniet me partnerët tradicionalë dhe të rinj.

Ajo tha se Otava do të krijojë gjithashtu koalicionë të bazuar në çështje të caktuara me shtete të vogla, fuqi të mesme dhe fuqi të mëdha për të përballuar sfidat e përbashkëta, ndërsa do të vazhdojë të forcojë sistemin më të gjerë shumëpalësh.

Anand tha se Kanada do të ndjekë një “realizëm të bazuar në vlera” dhe do të punojë me fuqi të tjera të mesme për të ndihmuar në formësimin e rendit ndërkombëtar në zhvillim.

“Ndërsa disa do të ndërtonin mure më të larta dhe do të tërhiqeshin nga angazhimi ndërkombëtar, ne besojmë se partneritetet afatgjata janë rruga drejt prosperitetit dhe sigurisë”, tha ajo.

Kanadaja paraqet prioritetet rajonale

Duke iu referuar prioritetëve të politikës së jashtme, Anand rikonfirmoi mbështetjen për Ukrainën dhe NATO-n, forcimin e lidhjeve me Evropën dhe bashkëpunimin më të madh me partnerët në Arktik.

Ajo premtoi gjithashtu vazhdimin e pranisë kanadeze në Indo-Paqësor dhe thellimin e marrëdhënieve ekonomike me Indinë dhe Kinën.

Kanadaja po kërkon mundësi të reja në Gjirin Persik dhe Amerikën Latine dhe po zgjeron marrëdhëniet tregtare me Afrikën, tha ajo. Sa i përket Haitit, Anand mirëpriti përgatitjet për zgjedhjet, duke pranuar njëkohësisht sfidat e vazhdueshme të sigurisë.

Ajo dënoi gjithashtu veprimet rajonale të Iranit dhe tha se Teherani nuk duhet të pajiset kurrë me armë bërthamore.

Sa i përket Izraelit dhe Palestinës, Anand tha se të dyja palët kanë të drejtë për vetëvendosje dhe rikonfirmoi mbështetjen e Kanadasë për një zgjidhje të negociuar me dy shtete.

Ajo tha se ngulimet izraelite në Bregun Perëndimor të pushtuar janë të paligjshme sipas së drejtës ndërkombëtare dhe përbëjnë pengesë për paqen, duke vënë në dukje vendimin e Kanadasë për të kufizuar tregtinë me mallrat nga vendbanimet kolone izraelite.

Sulmet e ushtrisë izraelite dhe të pushtuesve në Bregun Perëndimor janë intensifikuar që nga fillimi i luftës në Rripin e Gazës në tetor 2023. Të paktën 1.206 palestinezë, përfshirë 254 fëmijë, janë vrarë, rreth 13.350 janë plagosur dhe më shumë se 24.600 janë arrestuar gjatë kësaj periudhe, sipas të dhënave palestineze.

OKB-ja ka riafirmuar vazhdimisht se vendbanimet izraelite në territoret e pushtuara palestineze janë të paligjshme sipas së drejtës ndërkombëtare, duke paralajmëruar se ato minojnë perspektivat për zgjidhjen me dy shtete.

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Alarm për eksplozivë pranë bazës ajrore në Britani, arrestohen disa persona, evakohen banorët](#)

10:10 Bota

[Sulm vetëvrasës në një pikë kontrolli në Pakistan, të paktën 11 viktima dhe 18 të plagosur](#)

10:00 Bota / 2 komente

Stuhia përfshin verilindjen e SHBA-ve, New York dhe New Jersey shpallin gjendje emergjence

09:30 Bota



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.